

## Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare "AUTO DORI" SH.P.K.

Mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.B dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, Une themeluesi Z. Jani Hyseni me nr ID I70608063B, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "AUTO DORI" SH.P.K. me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Sot me datë 10/02/2021, formohet shoqëria tregtare private e quajtur "AUTO DORI" SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjisllacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjisllacionit ku do të ketë seline dega. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaket themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane, Kavaje, Lekaj, me Zone Kadastrale 2399, Numer Pasurie 280/45, Volumi 6, Faqe 151.

Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Veprimtari në fushën e Import- Eksportit të autovecurave dhe makinave të tjera të transportit, tregtim me pakice dhe shumice të këtyre mjeteve, etj.

Kohezgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shperbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5



1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë ( njeqind mije) Lekë.1.  
Ortaku themelues Z. Jani Hyseni: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme  
100.000(njeqind mije)leke, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.  
Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo  
të drejta).

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori Z. Jani Hyseni ,i cili do të jete dhe perfaqesuesi ligjore i saj. Ai është perfaqesuesi i Shoqërisë ne marredhenie me te tretet dhe kane kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do të kryhet prej Tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqërisë i takojne ortakeve.

Neni 8

Ortakët kanë të drejtë të emerojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale.

Kanë të drejtë të caktojnë financiere, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua në 2 kopje, për t’ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “AUTO DORI” SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

Ortaku themelues:

z. Jani Hyseni  
